

VENDIM
Nr.45, datë 27.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar	""
Manol Konomi,	Anëtar	""
Veli Budo,	Anëtar	""
Franc Jakova,	Anëtar	""
Alfred Karamuço,	Anëtar	""
Halil Kopani,	Anëtar	""
Kristofor Peçi,	Anëtar	""
Zija Vuci,	Anëtar	""

me sekretare Drita Filto e Arbenka Lalica, më datë 27.1.1997 dhe 20.8.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E: KONFEDERATA E SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga kryetari Kastriot Muço dhe n/kryetari Xhafer Dobrusha.

SUBJEKT I INTERESUAR:

FEDERATA SINDIKALE E MINATORËVE, GJEOLÓGËVE DHE ENERGJETIKËS TË SHQIPËRISË, me kryetar Mexhit Zogu, e përfaqësuar në gjyq me autorizim nga Z.Kadri Isufaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.151, datë 24.1.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, si edhe të vendimeve të dhëna nga gjykata e rrethit dhe ajo e Apelit Tiranë për padinë e ngritur kundër kërkuesit nga ana e subjektit të interesuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ka parashtruar se gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes civile që ka lindur midis saj dhe subjektit të interesuar, Federatës Sindikale të Minatorëve, Gjeologëve dhe Energjetikës së Shqipërisë, gjykatat e të tri shkallëve të gjyqimit kanë lejuar shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë cënuar të drejtat e saj themelore të parashikuara nga nenet 38 e 40 të ligjit kushtetues, që garantojnë të drejtën për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të një gjykimi të drejtë.

Gjykata, duke verifikuar këto pretendime të kërkuesit, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë gjyqësore si prej tij ashtu edhe prej përfaqësuesit të subjektit të interesuar, duke shqyrtuar për këtë qëllim, krahas vendimeve të gjykatave të zakonshme edhe të gjithë materialin e çështjes të grumbulluar prej tyre, konstatoi se:

Objekti i kësaj padije ka qenë i kufizuar. Subjekti i interesuar, Federata Sindikale e Minatorëve, Gjeologëve dhe Energjetikës, në padinë e vet e ka përcaktuar objektin e padisë, duke kërkuar njohjen e saj si pronare e vetme mbi shtëpinë e pushimit të punëtorëve (godina nr.1) në plazhin e Durrësit si dhe detyrimin e kërkuesit t'ia kthejë asaj këtë objekt së bashku me të ardhurat që ai ka realizuar si posedues i paligjshëm.

Gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr.5993, datë 15.09.1995, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kësaj padije dhe subjektin e interesuar e ka njohur vetëm si bashkëpronar në këtë pasuri.

Mbi ankimin e të dy palëve pjesëmarrëse në proces, Gjykata e Apelit Tiranë e ka shqyrtuar çështjen në shkallë të dytë dhe në vendimin e vet është shprehur tej objektit të padisë, duke vendosur njohjen e Federatës Sindikale të Minatorëve, Gjeologëve dhe Energjetikës mbi të gjithë pasurinë e

palujtshme që ka në pronësi Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë.

Një zgjidhje e tillë, vjen në kundërshtim me paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 117 të Kodit të Procedurës Civile, që ka qenë në fuqi në kohën kur është gjykuar kjo çështje.

Edhe kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, këtë shkelje e ka përsëritur në vendimin e vet. Ashtu si Gjykata e Apelit edhe ai është shprehur për të drejtën e bashkëpronësisë së subjektit të interesuar në krejt pasurinë që figuron e regjistruar në pronësi të kërkuarit.

Është e vërtetë se në objektin e padisë është bërë një shtesë me shkrim dore ku është shënuar se kërkohet veç të tjerave edhe njohja e subjektit të interesuar si bashkëpronar në krejt pasurinë që disponon kërkuari, por ky shënim është pa vlerë. Ai nuk është pasqyruar as në përmbajtjen e aktit të padisë, as në procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e rrethit dhe në atë të Apelit, madje as edhe në pretendimet që ka parashtruar pala paditëse në kërkesën e saj ankimore të ushtruar kundër vendimit të gjykatës së rrethit.

Gjykata çmon se ky qëndrim i Gjykatës së Apelit dhe asaj të Kasacionit, përbën shkelje me pasoja të rënda që kanë cënuar të drejtat themelore të kërkuarit. Atij i është hequr mundësia të realizojë të drejtën e mbrojtjes sepse, jo vetëm që nuk është vënë në dijeni për zgjerimin e objektit të padisë që ka bërë kryesisht Gjykata e Apelit, por në këtë drejtim nuk është zhvilluar fare gjyq.

Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Apelit dhe ajo e Kasacionit kanë shkelur parimin e kontradiktoritetit, i cili siç dihet, ka për qëllim t'u krijojë si paditësit ashtu edhe të paditurit mundësinë që në një proces civil të realizojë secili të drejtën e mbrojtjes, kërkesë kjo e domosdoshme për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të një gjykimi të drejtë (nenet 38 e 40 të Ligjit Kushtetues për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut").

Në këto rrethana, vendimet e sipërme të këtyre gjykatave, të cilat nuk kanë respektuar kërkesat e dispozitave të lartpërmendura të këtij ligji kushtetues, duhet të shfuqizohen si antikushtetuese dhe çështja t'i dërgohet për rigjykim Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo, në rigjykim, duhet t'i përmbahet objektit të padisë, dmth., të zgjidhë konfliktin për pronësinë vetëm për godinën nr.1, pjesë e shtëpisë së pushimit të punëtorëve në plazhin e Durrësit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 pika 9, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29. 4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.151, datë 24.1.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit e të vendimit nr.4359, datë 18.10.1995 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj të fundit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për këto arsye:

Vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Kasacionit, nuk janë antikushtetues, prandaj çështja nuk mund të gjykohej nga Gjykata Kushtetuese. Është e vërtetë se gjykatat pa të drejtë kanë shtuar objektin e padisë, por kjo shkelje e ligjit nuk ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor dhe garancinë për një gjykim të drejtë sipas neneve 38 e 40 të ligjit kushtetues për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Shkelje të tilla të procedurës së gjykimit dhe të tjera të kësaj natyre, mund të bëhen shkak për goditjen e vendimeve në rrugën e zakonshme të rekursit deri në rekursin për interes të ligjit që ushtron Prokurori i Përgjithshëm, duke kërkuar që çështja të gjykohej nga kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Kasacionit.

Në rastin konkret, shfuqizimi i vendimeve dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit nga ana e Gjykatës Kushtetuese, bën që kjo e fundit të kthehet në një instancë më të lartë gjykimi për çështje konkrete, gjë që është antikushtetuese.

ANËTAR
K. Peçi

Tiranë, më 27. 8.1997

ANËTAR
F. Jakova